

Kumtesa, mbajtur në simpoziumin «Probleme aktuale të traditës dhe të novatorizmit në letërsinë tonë të realizmit socialist» (24-25 maj 1973).

RAZI BRAHIMI

VAZHDIMËSIA DHE KALIMET NË ZHVILLIMIN E LETËRSISË

Vazhdimësia historike dhe lufta e të kundërtave janë dy prej komponentëve më kryesorë që përbëjnë dhe përcaktojnë, mbi bazën e kushteve të caktuara shoqërore, procesin e zhvillimit të letërsisë e të artit. Kjo e vërtetë dëshmohet më së miri edhe prej rrugës që ka ndjekur letërsia e realizmit socialist, që nga parahistoria e saj deri në ditët tona. Asnjë letërsi nuk do të bënte çap përpara në qoftë se nuk do ishin krijuar që më parë premiset e përparimit të saj të mëvonshëm, në qoftë se nuk do të zinte fill në elementin më pozitiv të së kaluarës e ardhmja e saj, dhe nga ana tjetër, do të ishte i pamundur çdo zhvillim pa mohimin e diçkaje që është vjetëruar dhe bie në kundërshtim me kërkesat e kohës, pa kapërcimin e stadeve të mëparshme të zhvillimit nëpërmjet kalimeve nga një etapë në tjetrën, nga një shkallë më e ulët në një shkallë më të lartë shoqërore dhe ideo-estetike.

Procesi i zhvillimit historik të letërsisë përmban në vetvete luftën e të kundërtave, që shpie më në fund, në fitoren e së resë mbi të vjetrën, paçka se disa herë ndeshemi edhe me turbullime kalimtare ose me dështime të përkohshme të së resë. Kështu, kur flasim për vazhdimësi historike dhe kujtojmë me këtë rast tezën e njohur të Leninit, sipas të cilit kultura socialiste është *vazhdim i natyrshëm* i gjithshkaje të mirë e demokratike që ka krijuar më parë njerëzimi, nuk kuptojmë më këtë shtrirje mekanike të së kaluarës në të tashmen as dhe një proces të qetë e spontan, po një zhvillim që arrihet në luftë e sipër e në të cilin pleksen shumë faktorë objektivë e subjektivë, shoqërorë e politikë, ideologjikë dhe etikë, estetikë dhe artistikë, që i japin letërsisë drejtimin në brendi e në formë.

Po të kthejmë kokën prapa dhe t'i hedhim një sy zhvillimit të letërsisë sonë kombëtare që prej përrallave dhe këngëve më të vjetra që kemi rregjistruar deri tek veprat e fundit të shkrimtarëve tanë të realizmit socialist, do të vërejmë se ato i përshkon filli i kuq i shqetësimeve dhe i mendimeve për njerëzit e thjeshtë, për popullin dhe për atdheun, i dashurisë së pastër e të zjarrtë për jetën, i shpirtit heroik dhe i idealeve demokratike, i urrejtjes për çdo formë skllavërie e çdo skllavërues; ato i përshkon një ndjenjë e hollë dhe e shëndoshë estetike, një prirje e përhershme gjithnjë më e fortë dhe më e sigurtë drejt së vërtetës dhe realizmit. Vazhdimësia në këtë rast është e natyrshme. Si populli edhe shkrimtarët e artistët e lidhur me popullin kanë përpunuar gjatë shekujve shijet dhe idealet e tyre dhe, mbi bazën

e trashëgimisë historike, i kanë përparuar dhe pasuruar ato duke i materializuar në atë mori të mrekullueshme krijimesh artistike e letrare, që përbën një pjesë me rëndësi të thesarit të kulturës sonë kombëtare. Procesi i përparimit dhe i pasurimit të letërsisë e të arteve popullore, demokratike dhe realiste, sa më tepër i afrohemi kohës sonë, aq më i shpejtuar dhe më i thellë bëhet, në vartësi prej zgjimit të ndërgjegjes patriotike dhe shoqërore të masave punonjëse, të shndërrimeve revolucionare të jetës, ngritjes së nivelit arësimor e kulturor të tyre, interesimit gjithnjë e më të madh të shoqërisë për letërsinë dhe artin, depërtimit gjithnjë e më të gjerë, më të thellë e më të sigurtë të ideologjisë revolucionare, që në kohën tonë është marksizëm-leninizmi. Letërsia jonë e realizmit socialist, për këto arsye, është trashëgimtarja më e natyrshme dhe vazhduesja më e denjë e gjithë traditës përparimtare, demokratike dhe realiste të së kaluarës dhe si vazhduese e tyre i ngre ato në një shkallë më të lartë, jo thjesht se është arritur një nivel mesatar që e kalon atë të mëparshmin, po, në radhë të parë, se parimet ideo-artistike dhe idealet që udhëheqin letërsinë tonë të re janë të një cilësie më të përparuar e më të lartë. Në këtë drejtim çdo krahasim i saj me letërsinë e vendeve të tjera borgjeze e revizioniste, pa marrë parasysh këtë rrethanë, do të ishte pa baza, në mos fare absurd.

Vazhdimësi historike ka edhe në drejtimet letrare dekadente e reaksionare, mbasi ashtu si shtresat e shtypura të çdo epoke lidhen ndërmjet tyre në prirjen drejt së ardhmes, ashtu edhe shtypësit, me gjithë ndryshimet ndërmjet tyre, janë hallka të të njëjtit zinxhir: të zinxhirit të shtypjes e të skllavërimit të çdo forme, që prej shfrytëzimit ekonomik, deri tek skllavërimi shpirtëror i masave me anë të ideologjisë, të fesë, të moralit dhe të artit të tyre dekadent e formalist. Karakteristikë e përgjithshme e kësaj vazhdimësie reaksionare në letërsi, sikurse edhe në jetën shoqërore, është kthimi ideologjik dhe artistik në të kaluarën, duke mos përballuar dot presionin e gjithanshëm të kohës ose çoroditja e plotë ideo-artistike si shprehje e nervozizmit, e ankthit, e shthurjes së plotë, e krizës së përgjithshme të rendit shoqëror kapitalist, e tmerrit para së ardhmes. Mikroborgjezia përbën rezervën e kësaj çoroditjeje të stimuluar nga vetë borgjezia.

Drejtimet e kundërta ideo-artistike përcaktojnë edhe fatet e kundërta historike të rrymave përparimtare dhe reaksionare; ndërsa të parat ndodhen në një proces të përhershëm përtëritjeje ideo-artistike, duke ecur në hap me zhvillimin shoqëror, të dytat vjen një kohë që marrin goditje vdekjeprurëse prej fitoreve revolucionare dhe paskëtaj vazhdojnë qënien e tyre në formë mbeturinash, duke gjetur strehë të përkohshme edhe në vetë letërsinë dhe artin përparimtar. Këto mbeturina u ngjajnë pjesëve të coptuara të një krymbi unazor, që po nuk u bënë pluhur përtërihen e rriten në përmasa të atilla, që vjen një kohë kur është vështirë të luftohen me sukses e me rrënjë. Kështu ndodhi, për shembull, në letërsinë dhe në artin sovjetik, në të cilin tendencat dekadente e formaliste, të lidhura edhe me traditën e mëparshme të dekadentizmit e të formalizmit rus, kanë marrë hov aq të madh, sa s'mund të pritët më asnjë ndryshim për mirë, pa ndodhur më parë një përmbysje politike revolucionare.

Në letërsinë dhe në artin e shoqërive me klasa antagoniste këto

drejtime të kundërta zhvillimi ecin paralelisht dhe në luftë me njëri-tjetrin dhe ndikojnë reciprokisht mbi njëri-tjetrin. Kështu ndodh që në letërsinë kulte e në folklorin e periudhave të ndryshme historike, krahas shtratis të fortë demokratik e realist të ndeshemi jo aq rrallë me elemente të ideologjisë, të etikës dhe të shijeve estetike dekadente e formaliste të klasave sunduese dhe këto depërtime, sidomos kur nuk janë thjeshtë letrare, përbëjnë një prej vështirësive më të mëdha të zhvillimit të mëtejshëm. Ndikime të kësaj natyre nuk është zor të gjejmë në shumë prej shkrimtarëve tanë të së kaluarës, që nga Serembja e Naimi e deri tek Migjeni, po sidomos në pjesë të krijimtarisë poetike të Asdrenit, të Lasgush Poradecit etj. Të tilla depërtime të trashëguara nga e kaluara ndeshim ndonjëherë edhe në letërsinë tonë të sotme, qoftë në formën e shfaqjeve konservatore, edhe në formën e ndikimeve moderniste. Një fakt i tillë na bën të mendojmë se duhet kujdes i madh dhe i vazhdueshëm për pastrimin e mëtejshëm të letërsisë së realizmit socialist prej këtyre trashëgimive, qofshin edhe latente, për fuqizimin e mëtejshëm të pozitave realiste socialiste të saj dhe për një zgjidhje dhe studim kurdoherë kritik të letërsisë së sotme e përparimtare botërore, e cila në masë e trajta të ndryshme, në brendi e në formën artistike, jep reflekse të ideologjive e të rrymave letrare që sundojnë në vendet kapitaliste e revizioniste.

Duke trajtuar këtë çështje dalim në një aspekt tjetër të vazhdimësisë historike të letërsisë: në ndikimin reciprok jo vetëm brenda kufijëve kombëtarë, po edhe në shkallë botërore. Ky ndikim as ka qenë dhe as është kryesori, mbasi çdo letërsi kombëtare ka zhvillimin e vetë të pavarur, të kushtëzuar nga gjëra që dihen, po sidoqoftë ai nuk mund të mohohet dhe as mund të nënvleftësohet, si në aspektin pozitiv edhe në atë negativ. Dhe historia e letërsisë sonë na jep një material të pasur për këtë çështje. Romantizmi dhe iluminizmi i Rilindjes, për shembull, ishin rezultat i procesit historik të formimit tonë si komb, i luftës për t'u çliruar prej zgjedhës së huaj dhe për t'u mbrojtur prej rrezikut të asimilimit kulturor, po në to gjejmë edhe gjurmët pozitive të ndikimit të romantizmit e të iluminizmit evropian të përpunuara në mënyrë krijuese në përshtatje me kushtet historike të vendit tonë dhe me drejtimet kryesore të lëvizjes sonë çlirimtare. Po kështu realizmi socialist e gjeti fillin në lëvizjen punëtore e komuniste në vendin tonë, sidomos në Luftën nacionalçlirimtare e në ndërtimin e socializmit, po s'mund të mos dallojmë në zhvillimin e kësaj letërsie të re edhe ndikimin e letërsisë revolucionare sovjetike, që çeli shtigjet e realizmit socialist.

Anën e kundërt të kësaj çështje do ta përbënte mundësia e ndikimit të huaj negativ, me të cilin jemi ndeshur edhe kohët e fundit.

Afërsia që krijohet ndërmjet epokash dhe periudhash të ndryshme të zhvillimit është një tjetër shfaqje e vazhdimësisë historike të letërsisë e të arteve. Përkim të plotë ndërmjet tyre nuk mund të ketë as nga pikëpamja ideologjike e shoqërore, as nga pikëpamja artistike megjithkëtë, sipas tendencës së përgjithshme përparimtare ose reaksionare të një epoke a një periudhe të caktuar historike, ndonjëherë edhe thjesht sipas drejtimeve politike që merr jeta e vendit, krijohet afërsi e natyrshme me letërsinë dhe artin e epokave dhe periudhave të mëparshme që u përshtaten deri në një farë shkalle kërkesave të reja

dhe mund të shërbejë si mbështetje për zhvillimin e letërsisë e të artit të ri. Kështu, për shembull, arti ynë i realizmit socialist dhe mendimi teorik e kritik i lidhur me të gjejnë mbështetje dhe marrin fuqi nga të gjitha ato periudha të zhvillimit artistik të njerëzimit në të cilat spikatën më mirë idetë dhe idealet e vërteta humanitare, demokratike e revolucionare të përfaqësuesve më të shquar të përparimit shoqëror dhe mishëron më qartë parimet e një arti të lidhur me jetën, të frymëzuar nga problemet e mëdha të kohës, të krijuar sipas shijeve të shëndosha estetike të popullit. A mund të gjejnë të njëjtën mbështetje në të kaluarën tendencat e sotme dekadente e formaliste të artit e të teorive borgjeze e revizioniste? Sigurisht që jo. Ato, përkundrazi, e gjejnë mbështetjen në traditën letrare e artistike të periudhave të dekadencës e të shthurjes shoqërore të së kaluarës, të kohëve të errëta që kanë shënuar fundin e klasave të dikurshme shfrytëzuese, të ideologjisë, të moralit, të shijeve e të pikëpamjeve të tyre estetike. Edhe prej një shikimi fare kalimtar e të sipërfaqshëm nuk do të ishte e vështirë të vihej re se si në artin e në letërsinë e sotme të vendeve ku sundojnë revizionistët po duken gjithnjë e më haptaz lidhjet me traditën më negative dekadente e formaliste të së kaluarës, pa përjashtuar as artin reaksionar kishëtar të mesjetës, as rrymat më të çoroditur të artit të sotëm borgjez imperialist. Kthimi i shumë shkrimtarëve dhe artistëve sovjetikë në traditën antirealiste të viteve '20, kujdesi dhe dashamirësia e tepëruar në studimin e kësaj tradite si dhe e gjithë krijimtarisë së shkrimtarëve dekadentë të së kaluarës dëshmon pikërisht tendencat dekadente e formaliste në vetë artin dhe letërsinë e sotme sovjetike, që stimulohen prej drejtimeve të zhvillimit të përgjithshëm shoqëror e politik të vendit.

Mendimi i vazhdimësisë historike dhe i mbështetjes në traditën e së kaluarës e në eksperiencën e të tjerëve përshkohet prej shqetësimit për të sotmen dhe të ardhmen e letërsisë e të artit, për ligjshmërinë e përparimit dhe të lartësimit të tyre të mëtejshëm, për ndjekjen hap pas hapi të kohës nëpërmjet braktisjes së elementit të vjetëruar dhe afirmimit të elementit të ri e të shëndoshë ideologjik. Prandaj, krahas studimit me kujdes të vazhdimësisë historike është gjithnjë e domosdoshme të shikohet me kujdes më të madh edhe procesi i kalimit të letërsisë nga një periudhë zhvillimi në tjetrën, nga një fazë e historisë së saj në fazën tjetër, gjë që arrihet nëpërmjet grumbullimit gjithnjë më të shumtë të elementeve të reja ideo-artistike dhe luftës shumëformëshe kundër elementeve të vjetëruara e rutinës. Në rastet kur zhvillimi artistik merr drejtim së prapthi drejt dekadentizmit e formalizmit dhe këto tendenca marrin pozita dominuese, atëhere edhe lufta brenda e jashtë truallit bëhet nga këto pozita në dëm të letërsisë së vërtetë përparimtare, realiste e revolucionare. Kështu edhe kur flasim për kalime gjithnjë do mbajtur parasysh jo kalimi në vetvete, po karakteri objektiv i këtij kalimi, në mënyrë që me kohë të zbulohet e të stimulohet elementi i ri dhe i shëndoshë dhe të hetohet depërtimi i elementit kalbëzues, pa e lënë atë të grumbullohet në masë të atillë sa të rrezikojë vetë përparimin. Kritika që po bëhet sot kundër ndikimeve borgjeze e revizioniste edhe në fushën e letërsisë e të arteve ka pikërisht për qëllim, që duke u nisur prej sukseseve më të mira që kanë arritur shkrimtarët dhe artistët tanë të realizmit socialist dhe prej dëshirës

për të konsoliduar dhe për të shpënë më përpara fitoret e arritura, të goditet çdo ndikim i huaj dekadent e formalist, të mos lejohet asnjë farë nënshtrimi para presionit të tyre dhe të sigurohet që në të ardhmen fenomene të kësaj natyre të mos përsëriten më.

Kalimet e letërsisë nga një stad në tjetrin, nga një metodë artistike në një metodë tjetër artistike si dhe ndryshimet cilësore që ndodhin vazhdimisht edhe brenda caqeve të letërsisë së një periudhe historike janë po aq të natyrshme e të ligjshme, sa edhe vetë procesi i vazhdimësisë. Ato janë shfaqje të unitetit dhe të luftës së të kundërtave të paktën në tre drejtime kryesore: ndërmjet të kaluarës dhe të ardhmes për kapërcimin e të parës nga e dyta, ndërmjet rrymave përparimtare e reaksionare, realiste e formaliste të së njëjtës kohë dhe ndërmjet anëve që vjetërohen dhe krijojnë dhe anëve të reja që lindin dhe përfaqësojnë të ardhmen brenda të njëjtit drejtim ose të njëjtës metodë artistike.

Historianët tanë të letërsisë, duke u mbështetur në një material të pasur, kanë përvijuar (ndonëse ende jo plotësisht), rrugën e zhvillimit shekullor të letërsisë sonë kombëtare që prej veprave të para me karakter dogmatik e ritual fetar deri në krijimet e sotme të shkrimtarëve të realizmit socialist. Do të meritonin të përmendeshin në këtë rast kalimi prej letërsisë në gjuhën latine e greke që ka të ngjarë të ketë ekzistuar para Buzukut në letërsinë e shkruar në gjuhën shqipe; kalimi prej letërsisë fetare, krähinore, feudale në letërsinë kombëtare romantike të Rilindjes; kalimi prej kësaj të fundit në letërsinë demokratike realiste me tendenca revolucionare të viteve '20, '30 dhe, së fundi, kalimi duke nisur gjatë Luftës nacionalçlirimtare në pozitën e realizmit socialist. Edhe brenda për brenda secilës prej periudhave të mëparshme vihen re kalime ideo-artistike, që përbëjnë vetë procesin e fillimeve, të formimit, të lulëzimit, të krizës dhe të kalimit në periudhën pasuese, megjithë gërshetimet e shpeshta që vihen re ndërmjet tyre. Shkrimtarët më të shquar përparimtarë, duke reflektuar në krijimtarinë e tyre kushtet e reja historike, bëhen prekursorë dhe flamurtarë të këtyre kalimeve. Kështu ndodhi me De Radën e me Naimin, pas Varibobës dhe bejtexhinjve, me Çajupin, Asdrenin e Mjedën pas Naimit, me Nolin e me Migjenin para fundit të letërsisë së Rilindjes dhe me shkrimtarët tanë të sotëm — pionierë të realizmit socialist. Dhe ndërmjet këtyre shkëlqimeve dalngadalë është grumbulluar elementi i domosdoshëm ideo-artistik që ka shpënë në ndryshimet e dukshme cilësore për të cilat po flasim. Si çdo fushë tjetër edhe në letërsi mohimi dhe pohimi janë dy anë të të njëjtit proces, prandaj çështja është jo të diskutojmë në duhet apo s'duhet pranuar ky ligj dialektik, po të studjojmë me vëmendje në çdo etapë përmbajtjen e mohimit e të pohimit, tendencën që përfaqësojnë ato si dhe rrugët më të mira të kalimit me sukses nga një fazë zhvillimi në një fazë tjetër më të lartë. A është kryer një proces i tillë zhvillimi, pohimi dhe mohimi, në letërsinë tonë të realizmit socialist. Ndonëse shkalla e studimeve tona për këtë problem me rëndësi nuk është aq e lartë, prap se prap kritika ka vënë në dukje më se një herë ndryshimet që kanë ndodhur gjatë tridhjetë vjetëve të fundit në letërsinë tonë dhe është munduar të zbulojë në çdo fazë zhvillimi ato elemente të reja që kanë siguruar përparimin dhe lartësimin ideo-artistik të krijimtarisë letrare kombëtare. Dhe, në qof-

të se pranojmë asimilim krijues të eksperiencës, përpunim të vlerave ideo-artistike, bashkëkohësim të përhershëm të letërsisë, atëherë në çdo fazë do të kërkojmë domosdo atë element të ri që shpërthen e çan drejt së ardhmes me guxim dhe do të mohojmë atë element të vjetëruar të cilit i ka kaluar koha, është bërë anakronik, është kthyer në rutinë e në pengesë për zhvillimin e mëtejshëm. Një përmbajtje të tillë mendoj se ka ose duhet të ketë edhe diskutimi ende aktual për dy fazat kryesore të zhvillimit të letërsisë sonë të realizmit socialist, para vitit 1960 dhe pas tij. Në të dyja këto faza me rëndësi ne kemi patur dhe kemi një letërsi të realizmit socialist dhe nga çdo pikëpamje ta marrësh, faza e parë domosdo ishte fillestare, përballoi probleme e vështirësi të shumta, pati realizime të shkëlqyera po edhe kufizime të përligjura ndërsa në fazën e dytë, arrihet një nivel më i lartë ideo-artistik, synohet për të ngushtuar distancën ndërmjet zhvillimit shoqëror e letrar, pasurohet tematika dhe rritet pesha e mendimit, kapërcen disa shfaqje tradicionalizmi në formë, rriten pretendimet artistike etj. Ky kalim me rëndësi për letërsinë tonë nuk u krye as qetas, as mekanikisht e menjëherë. Ai u përgatit prej fazës së mëparshme, u pararend prej veprave më të mira të saj, u mbështet mirë në traditën e mëparshme kombëtare, sidomos të viteve '30, njohu më tepër ndikimin pozitiv, po ndonjëherë edhe negativ të letërsisë së huaj, u pleks shpesh me fenomene karakteristike për fazën e mëparshme, pati garë në fushën e krijimtarisë e të mendimit kritik dhe në këtë luftë nuk qenë aq të rralla as shfaqjet e mbivlerësimit të eksperiencës së grumbulluar, as qëndrimet subjektivistike ndaj vlerave pozitive të krijuara më parë. Në historinë e letërsisë sonë të realizmit socialist ky ka qenë kalimi më spikatës nga një fazë në tjetrën dhe përvoja e fituar pa tjetër do të ketë vlerë edhe për zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë e të mendimit kritik. Në letërsinë tonë ka ndodhur e do të ndodhë ngaherë që të mohohet diçka e vjetëruar e vetvetes dhe të pohohet ngaherë diçka e re, e lindur po prej vetvetes e prej kushteve të reja shoqërore, që do të afirmojë jo rryma e metoda të tjera, po vetë realizmin socialist të ngritur në një shkallë të re.

Shqyrtimi subjektivist i këtij procesi ka shpënë kurdoherë në acarime artificiale, në kundërvënie antihistorike të fazave të zhvillimit, në mbivlerësime të njëanshme praktikash dhe fenomenesh, siç ka shpënë edhe në qëndrime objektivistike ndaj krijimtarisë së një periudhe, pa dalluar mirë në të, bile edhe në veprën e çdo shkrimtari, atë që përfaqëson vërtetë tendencën objektive të zhvillimit nga anët e vjetëruara që duhen flakur dhe nga elementi i huaj që depërton dhe krijon rrezikun e shmangies prej vetë realizmit socialist. Realizmi socialist nuk është një metodë artistike e krijuar subjektivisht, po fruti i zhvillimit objektiv të letërsisë e të artit dhe besimi në të ardhmen e tij nuk mbështetet në dëshira personash, po në të ardhmen e socializmit e të revolucionit.

*Résumé*CONTINUE ET PASSAGES DANS LE DEVELOPPEMENT
DE LA LITTERATURE ALBANAISE CONTEMPORAINE

Le processus du développement historique de la littérature contient en soi la lutte des contraires, qui porte en dernière instance à la victoire du nouveau sur l'ancien, sans égard si parfois on se bute à des troubles passagers ou à des échecs temporaires du nouveau.

Si l'on jette un regard d'ensemble, on voit que plus on s'approche à notre temps, d'autant plus accéléré et plus profond devient le processus du progrès et de l'enrichissement des lettres et des arts populaires, démocratiques et réalistes. Notre littérature du réalisme socialiste est l'héritière la plus naturelle et la continuatrice la plus digne de toute la tradition progressiste, démocratique et réaliste du passé. Les directions contraires idéologiques et artistiques entraînent aussi les destinées contraires historiques des courants progressistes et réactionnaires. Si les premiers se trouvent dans un processus constant de renouvellement, en procédant au pas de l'évolution sociale, les deuxièmes se butent, à un certain temps, contre le coup mortel asséné par les victoires révolutionnaires, et ne continuent ensuite qu'à végéter, languir sous forme de vestiges, en trouvant un abri temporaire aussi dans les lettres et l'art progressiste. Cependant, on ne peut pas les laisser se renouveler, autrement on assiste à ce qu'il est arrivé en Union soviétique, où les tendances décadentes et formalistes, ancrées à la tradition antérieure du décadentisme et du formalisme russes, ont connu une telle ampleur, qu'on ne peut s'attendre à un changement dans le bien, sans l'intervention préalable d'un renversement politique révolutionnaire.

Des infiltrations suspectes, héritage du passé, sont rencontrées parfois aussi dans notre littérature contemporaine, tant sous forme d'apparitions conservatrices, que sous celle d'influences modernistes. Un tel fait porte à réfléchir sur le soin constant qu'on doit mettre à l'épuration ultérieure de la littérature du réalisme socialiste de ces héritages, même si sous une forme latente, afin de raffermir de plus en plus ces positions réalistes socialistes.

Une autre considération du domaine de la continuité concerne l'influence mutuelle non seulement à l'intérieur des frontières nationales, mais aussi au niveau mondial. Cette influence n'est pas la principale, puisque toute littérature nationale connaît son développement indépendant, pourtant elle ne peut être ni démentie ni sous-estimée, tant pour ce qui est de son aspect positif que de celui négatif.

Le rapprochement qui se crée entre époques et périodes différentes de développement est une autre manifestation de la continuité historique des lettres et des arts. Entre ces aspects il ne peut y avoir des concordances complètes ni au point de vue idéologique et social, ni sous celui artistique. Néanmoins, d'après la tendance générale progressiste ou réactionnaire d'une époque ou d'une période historique donnée, parfois même d'après les orientations politiques qu'assume la vie du pays, il se crée des affinités naturelles avec les lettres et les arts de ces époques et périodes antérieures qui vont dans une certaine mesure aux nouvelles demandes et peuvent servir d'appui pour le développement des nouvelles lettres et du nouvel art.

L'opinion de la continuité historique et de l'appui sur la tradition du passé et sur l'expérience des autres est empreinte par la préoccupation pour le présent et l'avenir des lettres et de l'art, pour la régularité du progrès et de leur élévation

ultérieure, afin de suivre pas après pas l'évolution du temps, en abandonnant l'élément vieilli et en affirmant le nouvel élément idéologique sain. Partant, il est toujours nécessaire de suivre attentivement aussi le processus du passage de la littérature d'une période à l'autre, d'une phase de son histoire à l'autre.

Quand on parle de passage, on doit tenir présent non point le passage en soi, mais le caractère objectif de ce passage, de sorte à pouvoir découvrir et stimuler le nouvel élément sain et dépister l'élément pourrissant, ne pas lui permettre de s'accumuler dans une telle mesure à risquer le progrès. La critique d'aujourd'hui contre les influences bourgeoise et révisionniste vise à ce but.

Les passages de la littérature d'un stade à l'autre, d'une méthode artistique à l'autre, ainsi que les changements qualitatifs qui ont lieu continuellement aussi à l'intérieur des limites de la littérature d'une période historique, sont aussi naturels et légitimes que le processus même du passage.

Ce passage, l'auteur Brahimi le divise en deux phases pour les lettres albanaises: avant 1960 et après 1960. La phase initiale, celle avant 1960, a eu à faire face à des problèmes et à des difficultés plus nombreuses, elle a connu des réalisations brillantes mais également des limitations sensibles et justifiées. Au contraire, dans la deuxième phase est réalisé un niveau idéo-artistique plus élevé, on a visé à rétrécir l'écart entre le développement social et littéraire, on a enrichi la thématique et on a fait accroître le poids de la réflexion, on a surmonté quelques manifestations du traditionnalisme dans la forme, on s'est battu contre la routine, les exigences artistiques se sont accrues, etc.

Ce passage important pour notre littérature n'a eu lieu ni tranquillement, ni mécaniquement, ni d'emblée. Il a été préparé par la phase antérieure, a été précédé par ses meilleures productions, s'est appuyé parfaitement dans la tradition antérieure nationale, surtout dans celle des années 30, a mieux connu l'influence positive, mais parfois aussi négative de la littérature étrangère, s'est mélangé souvent avec des phénomènes caractéristiques à la phase antérieure, il y a eu émulation et lutte dans le domaine de la création et de l'opinion critique, et dans cette lutte n'ont pas été rares ni les manifestations de surévaluation de l'expérience accumulée, ni les attitudes subjectives envers les valeurs du passé. Néanmoins, il représente, dans notre littérature du réalisme socialiste, le passage le plus remarquable d'une phase à l'autre et l'expérience acquise aura, sans nul doute, toute sa valeur aussi dans le développement ultérieur de la littérature et de la critique.

Le réalisme socialiste n'est point une méthode artistique engendrée subjectivement, mais le fruit du développement objectif des lettres et des arts; la confiance dans son avenir ne repose point dans le désir de singuliers, mais dans l'avenir même du socialisme et de la révolution.